



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARSELA Q. ELMAZAJ
ADRESA NR.5, BLV "BAJRAM
CURRI", P."I MAJ", SHKALLA NR.7,
NR.1/1
TEL: 695271242



VERTETIM NENSHKRIMI

(STATUTI)

Nr. repertori: 1409

Tirane më 24/07/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2020053210058459494

STATUT
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“P&C Solutions” sh.p.k

NENI 1

Themelohet sot ne daten 24 /07/2020 shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “P&C Solutions” sh.p.k, me kontributin e ortakeve :

- 1- **Asiap Gruda**, i biri i Xhemil, lindur me 11.05.1969, lindur ne Stebleve, Dibër dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotesi te plote juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim ID me nr.personal **G90511057P**.
- 2- **Albert Gruda** , i biri i Xhemil , lindur me 28.07.1975 ne Stebleve, Dibër banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me Letërnjoftim ID me nr.personal **H50728124S**.
- 3- **Jona Josifi** , e bija e Aleksander-it , lindur me 14.06.1989 ne Durres dhe banuese ne Durres , madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , identifikuar me Letërnjoftim ID me nr.personal :**I95614060T**.

NENI 2

VEND QENDRIMI

Vend qendrimi legal i shoqerise do te jete ne adresen Shoqeria e ka seline ne adresen Vaqarr, Tirane , Z.K.2376, vol 4, faqe 125 me nr pasurie:100/9, adrese Lalm Tirane, me siperfaqe totale1750 m2, nga e cila ndertese 1000 m2, por ajo ka te drejte te hape edhe vend qendrim te tjera operative, filiale, dege,perfaqesi dhe agjensi ne te gjithë vendin. Gjithashtu ajo ka te drejte te hape edhe ne shtete te huaja,gje qe realizohet me miratimin e organeve kopetente dhe sipas legjislacionit ne fuqi te vendit te huaj.

NENI 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte 15 vjet, por ortaket e saj , sipas ligjit ne fuqi mund ta shperbejne ate ne cdo kohe.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

Import eksport. Prodhim dhe tregtim ambalazhimi, paketimi te te gjitha llojeve, riciklim letre e kartoni te te gjitha llojeve, menaxhim, seleksionim, transport, tregtim të mbetjeve urbane Tregti me shumice e pakice te produkteve petro kimike, etj.

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar “P&C Solutions” sh.p.k është 100 000 (njëqind mijë) Lekë dhe është i ndare në 3 (tre) kuota .Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre. Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Asiap Gruda 1 Kuote, me vlerë 20.000 Lek, zotëron 20% (njetete perqind) .
Albert Gruda 1 Kuote, me vlerë 40.000 Lek, zotëron 40% (dyzete perqind).
Jona Josifi 1 Kuote, me vlerë 40.000 Lek, zotëron 40% (dyzete perqind).

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ne cdo kohe sipas vendimit qe mund te marrin ortakët e saj.

NENI 6

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqeria është prone e ortakëve të cilët drejtojnë aktivitetin ekonomik dhe financiar të saj, duke u mbështetur në të drejtën e pronësive private, të mjeteve të investuara në shoqëri etj..

NENI 7

HYRJA NE FUQI

Shoqeria e mesipërme deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut dhe ato të legjislativës shqiptare në fuqi. Kjo shoqëri fiton zotësi për të vepruar me rregjistrimin në QKR.

NENI 8

Shoqeria ka vullnet të saj . Shoqeria mund të hapë llogari në çdo bankë shqiptare si dhe nuk është e kufizuar në bankat jashtë territorit shqiptar.

NENI 9

Shoqeria vepron me të drejtat e pronës private dhe merr përsipër vet të drejtat dhe detyrimet. Ajo përgjigjet për detyrimet e saj kontraktore brenda kapitalit të vet si dhe me mjetet financiare të grumbulluara e të ndara sipas organit kompetent, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

NENI 10

Shoqeria me përgjegjësi të kufizuar ka të drejtë të punësojë persona fizike, vendas dhe të huaj, për të realizuar qëllimin e fitimit dhe zgjerimin e saj, por gjithmone me specialiste të kualifikuar, sipas vendimeve të organeve drejtuese të saj. Punësimi bëhet nëpërmjet kontratës së punës kolektive ose individuale dhe në përputhje me legjislativin e punës në fuqi për sigurimet shoqërore etj.

NENI 11

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis punemarresve dhe punedhenesit do te zgjidhet nga Gjykata kopetente.Gjykata kopetente do jete ajo e Tiranës.

NENI 12

Shoqeria ka te drejte te krijojë fondin e saj rezerve te kapitalit per zhvillim,per krijimin e rezerves per shperblimin e punonjesve te punesuar ne te dhe per krijimin e rezervave te tjera.

NENI 13

Pjeset e kapitalit themeltar te shoqerise jane lirisht te transferueshem.Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial.

NENI 14

- 1- Administrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "P&C Solutions" sh.p.k, eshte **Jona Josifi** , e bija e Aleksander-it , lindur me 14.06.1989 ne Durres dhe banuese ne Durres , madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me Letërnjoftim ID me nr.personal :**I95614060T**, per nje periudhe 5 vjecare.

NENI 15

Ortaket e shoqerise jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise,pa asnje perjashtim dhe kufizim. Ata kane te drejte te kyejne te gjitha aktet qe i konsideron te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Ata kane te drejte te bleje dhe te kembeje pasuri,te lidhet me shoqeri te tjera si dhe te kryeje cdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave shteterore e private qe kane te bejne me garancite,veprimet hipotekore etj..

NENI 16

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashgimie.Pjeset e kapitalit fillestar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqerine,vetem me miratimin e ortakeve.Projekti i transferimit i njoftohet shoqerise.Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit,si me lart,miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit,ortaket brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi,duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vleren e percaktuar.

NENI 17

Vendimet merren nga ortaket e shoqerise.

NENI 18

Ne mbledhjet e asamblese ose ne konsultimet me shkrim, vendimet merren me pelqimin e ortakeve te vetem te shoqerise.

NENI 19

Ndryshimet e statutit te shoqerise vendosen nga ortaket e vetem.

NENI 20

MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtje qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen nga Gjykata e Shqiperise. Kur pala ankuese eshte person i huaj, mosmarreveshja zgjidhet nga organi qe percaktohet ne kontraten e punes.

Punonjesit e emeruar si dhe administratori i emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit qe realizon shoqeria gjate ushtrimit te aktivitetit te saj. Per punen e tyre punonjesit marrin pagen sic eshte parashikuar ne kontraten e punes.

NENI 21

Administratori i shoqerise emerohet dhe shkarkohet nga mbledhja e asamblese se ortakeve te shoqerise. Ata nuk mund te marrin cilesine e ortakeve ne shoqeri dhe as te ushtroje nje aktivitet kontraktues te cfardo lloji per llogari te tij dhe te tjereve, pervec atyre te autorizuar nga asambleja e ortakeve te vetem te shoqerise. Per cdo shkelje ne kete drejtim, administratori largohet nga puna dhe pergjigjet per demet e shkaktuar.

NENI 22

Ortaket caktojne pagat per te punesuarit e shoqerise. Shoqeria merr persiper te respektojte legjislacionin ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore ne Republiken e Shqiperise, ndersa te gjitha te punesuarit jane te detyruar te pranojne kete te shoqerise.

NENI 23

Administratori i shoqerise perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te trete, kryen veprime bankare dhe financiare. Gjithashtu ai ka te drejta dhe detyrime qe jane te percaktuara ne legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 24

Ortaket e vetem te shoqerise ne cdo kohe kane te drejte te parashtrojne verejtjet e tyre me shkrim mbi punen e kryer ne shoqeri.

NENI 25



Te gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës. Sekret paraqesin shkresat, materialet dhe aktet, të cilat me ligje dhe dispozita të vecanta janë shpallur si të tilla. Te dhëna informative, plane, bilance, informacione mbi politiken e shoqërisë si dhe materiale dhe dokumente të tjera të këtij lloji ju paraqiten të tretëve me miratim të asamblese së ortakëve të vetëm.

NENI 26

Perfaqësimi i shoqërisë i përket ortakëve të vetëm të saj. Ata kanë të drejtë të perfaqësojnë shoqërinë edhe në organet gjyqësore, të ngarkojë dhe të pushojë avokate etj...

NENI 27

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë mbylleen në 31 Dhjetor të çdo viti përveç urdherave të vecanta që jepen nga ortakët e shoqërisë. Në fund të çdo periudhe ushtrimor, administratori i shoqërisë nxjerr bilancin kontabel me rezultatin ekonomik, fitim-humbje, bazuar në rregullat e mbajtjes së kontabilitetit nga shoqëritë tregtare të percaktuara nga organet kompetente të sistemit fiskal.

Bilanci kontabel miratohet nga ortakët e shoqërisë. Me miratimin e bilancit vjetor kontabel të shoqërisë, ortakët e vetëm të shoqërisë vendos për krijimin e fondeve të ndryshme.

NENI 28

Te ardhurat neto të shoqërisë, pas vecimit të fondeve, nëse do të percaktohen të tilla, përfitohen nga ortakët e vetëm të shoqërisë **“P&C Solutions” sh.p.k.**

NENI 29

Shperberja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkakut si humbje kapitali, pamundësi veprimtare ose me vendim të ortakëve të shoqërisë. Në këtë rast këta të fundit caktojnë një ose më shumë likuidatore dhe vendos për mënyrën e likuidimit.

NENI 30

DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Përsa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut i referohet ortakëve të vetëm të shoqërisë për plotësimin si dhe ligjeve të vecanta në fuqi.


Ndryshimet dhe plotësimet në këtë statut behen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë me të cilën nxirret vete statuti.

Ky statut hyn në fuqi nga dita e nxjerrjes së tij dhe rregjistrimit QKR.


Ai nënshkruhet rregullisht nga ortakët e vetëm të shoqërisë.

ORTAKET


Asiap Gruda



Albert Gruda



Jona Josifi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MARSELA Q. ELMAZAJ

Rep: 1409



V2020053210058459494



VËRTETIM NËNSHKREMI

Sot, më datë 24/07/2020, para meje Notere MARSELA Q. ELMAZAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, BLV"BAJRAM CURRI", P."1 MAJI", SHKALLA NR.7, NR.1/1, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Asiap Gruda, atësia Xhemil, amësia Sanije, shtetas Shqiptar, lindur në Steblevë, Dibër dhe banues në TIRANË, me adresë 1005 TIRANË VIOLETA MANUSHI 78 1, lindur më 11/05/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 030012142 dhe nr. personal G90511057P , .

NËNSHKRUES/IT:

Albert Gruda, atësia Xhemil, amësia Sanije, shtetas Shqiptar, lindur në Steblevë, Dibër dhe banues në TIRANË, me adresë Njesia bashkiake nr. 3 Sadik Petrela 0 0 0, lindur më 28/07/1975, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 030860546 dhe nr. personal H50728124S , .

NËNSHKRUES/IT:

Jona Josifi, atësia Aleksandër, amësia Merita, shtetas Shqiptar, lindur në Durres, Durres dhe banues në DURRES, me adresë 2025 DURRËS TAULANTIA 00690806 16 9 5, lindur më 14/06/1989, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 024820700 dhe nr. personal I95614060T , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, Statut "P&C Solutions" shpk, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
MARSELA Q. ELMAZAJ

Marsela Q. Elmazaj